




Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



DREJTORIA E ARSIMIT
PODUJEVË

Nr. 05 - 412
20.10.2022

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës nr. 03/L-212 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.90/2010) nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin Parauniversitar të Republikës së Kosovës nr.04/L – 032, të Ligjit për Arsimin në komunat e Kosovës nr. 03/L-068, Udhëzimit Administrativ Nr.05/2021, (MASHI) i datës 18.06.2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm dhe Udhëzimet Administrative (MASHTI) nr. 05/2015, Udhëzimit Administrativ Nr.07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, si dhe kërkesave e nevojave për plotësimin e vendeve të lira të punës për mësimdhënës të shkollave fillore dhe të mesme të komunës së Podujevës, Drejtoria e Arsimit, shpall :

KONKURS
PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË PUNËS

Nr.	Niveli	Pozita	Vendi lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave	Nr. i orëve
1	ShMLT	Mësimdhënës/e për lëndë ekonomike	Zëvendësim	1	10-orë

I. Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Formulari i aplikimit i plotësuar(merret në komunë - Qendra për shërbime me qytetarë);
- Rezymeja personale (CV);
- Dokumenti personal(letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat), certifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri dhe jo më të vjetra se gjashtë muaj. Çdo certifikatë e diplomës më e vjetër se gjashtë muaj nga data e diplomimit, nuk do të merret parasysh;
- Certifikata që nuk jeni nën hetime;
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

II. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve të stafit mësimor:

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji Nr. 02/L-52, Ligji Nr. 03/L-068 dhe Ligji Nr. 04/L-138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHTI-it (UA Nr. 05/2021) , Udhëzimet Administrative të (MASHTI) nr. 05/2015 si dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik.

- **Kriteret e kualifikimit për mësimdhënës/e për lëndë ekonomike në shkollë të mesme të lartë:**
 - MSc. i ekonomisë ;
 - Ekonomist i përgjithshëm.

VËREJTJE: Sipas Udhëzimit administrativ (MASHTI) NR.05/2021 për normativin mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm, neni 6 paragrafi 18, "Të gjithë kandidatët e kualifikuar në nivelin arsimor 300 ECTS për disiplinat nga paragrafi 1-17 të këtij neni, në fakultetet tjera përveç Fakultetit të Edukimit, të cilët i kanë filluar

studimet para hyrjes ne fuqi te UA nr.06/2015 të datës 10.07.2015, i plotësojnë kriteret për punësim”. neni 11 paragrafi 3, “Të gjithë të kualifikuarit në njësitë akademike që kanë përfunduar master arsimor 300 ECTS, kanë të drejtë të barabartë konkurrimi në arsimin parauniversitar të paraparë në nenin 6 të këtij Udhëzimit administrativ”.

- Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen
- Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do t'i nënshtrohen testimit me shkrim. Testi me shkrim në maksimum tërheq 100 pikë apo deri 50% të vlerësimit përfundimtar.
- Kandidatët që arrijnë së paku 50% të pikëve nga testi me shkrim, i nënshtrohen intervistimit me gojë. Në intervistën me gojë, kandidatët mund të vlerësohen në maksimum deri 100 pikë apo 50% e vlerësimit përfundimtar.
- Vlerësimi në intervistimin me gojë, bazohet në këto kritere :
- Njohuritë e përgjithshme 25 pikë
- Aftësitë e përgjithshme dhe personaliteti 35 pikë, dhe
- Njohuritë profesionale 40 pikë ku përfshihen përvoja e punës dhe kualifikimi profesional gjatë studimeve).
- Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitë të lartçekura.
- Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).
- Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të jenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.
- Për intervistë do të ftohen ata kandidat/e të cilët/at i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartçekura.
- Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test, intervistë, si dhe orari i intervistave publikohet në web faqen e komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (konkurset).
- Me këtë konkurs zhvillohen procedurat e rekrutimit për vitin shkollor 2021-2022. Në rast të ndonjë nevojë eventuale për mësimdhënës/e në IEAA, do të bëhen angazhime sipas renditjes së listave pritëse.
- Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit.

III. Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në tabelën e shpalljeve në objektin e komunës dhe në ueb-faqen e Komunës së Podujevës <http://kk.rks-gov.net/podujeve> (20/10/2022 - 03/11/2022).

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në komunë përmes protokollit, përkatësisht përmes Qendrës për shërbime me qytetarë.

Vërejtje: Pas aplikimit kandidatët të ruajnë dëshminë e aplikimit, e cila është e domosdoshme për fazat e tjera të procedurave të konkursit.

